

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës
dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

Barazia Gjinore



Anketa e Treguesve të Shumëfishtë




Barazia gjinore nënkupton që vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, gëzojnë të njëjtat të drejta, burime, mundësi dhe mbrojtje. Investimet në barazinë gjinore kontribuojnë në rezultate pozitive gjatë gjithë jetës për fëmijët dhe komuniteteve që i takojnë, dhe gjithashtu kanë përfitime të konsiderueshme ndër breza, sepse të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve shpesh varen nga të drejtat dhe mirëqenia e grave. Kjo pasqyrë paraqet dimensionet kryesore të barazisë gjinore gjatë ciklit të jetës. Ajo organizohet rreth: 1) dekadës së parë të jetës (mosha 0-9 vjeç) kur pabarazitë gjinore janë shpesh të vogla, veçanërisht në fëmijërinë e hershme; 2) dekada e dytë e fëmijërisë (mosha 10-19 vjeç) kur pabarazitë gjinore bëhen më të theksuara me fillimin e pubertetit dhe konsolidimin e normave gjinore; dhe 3) mosha e rritur, kur pabarazitë gjinore ndikojnë në mirëqenien e grave, dhe vajzave dhe djemve.

Çdo vajzë dhe djalë mbijeton dhe zhvillohet: Dekada e parë e jetës

Ushqyeshmëria dhe mjedisi mbështetës në fëmijërinë e hershme janë ndër përcaktuesit kryesorë të shëndetit dhe mbijetesës së fëmijëve dhe zhvillimit fizik dhe kognitiv. Në përgjithësi, vajzat kanë tendencë të kenë tipare më të mira biologjike sesa djemtë për të mbijetuar deri në moshën pesë vjeç, dhe kështu mundësi më të larta mbijetese në rrethana natyrore. Sidoqoftë, diskriminimi gjinor ndaj vajzave mund të ndikojë në mbijetesë, duke rezultuar në vdekshmëri të femrave më të lartë se sa e pritej. Në mënyrë të ngjashme, shkalla e ngecjes në zhvillim zakonisht është më e ulët tek vajzat sesa djemtë, potencialisht për shkak të rrezikut më të lartë për lindje të parakohshme tek djemtë, gjë që pa dyshim lidhet me nën peshën në lindje. Sidoqoftë, fëmijët me nëna që kanë lindur në moshë të re ose që nuk kanë arsimim kanë gjasa më të mëdha për kequshqyerje. Fëmijët me zhvillim të kufizuar kognitiv gjatë fëmijërisë së hershme janë në rrezik për probleme të mëvonshme neuropsikologjike, arritje të dobëta shkollore, braktisje të hershme të shkollës, punësim i nivelit të ulët dhe kujdes jo të mirë për fëmijët e tyre. Stimulimi dhe ndërveprimi me prindërit dhe kujdestarët mund të fillojnë zhvillimin e trurit dhe të promovojnë mirëqenien në fëmijërinë e hershme. Kjo është gjithashtu periudha e zhvillimit kur manifestohet socializimi gjinor, ose procesi i mësimi të roleve kulturore sipas gjinisë. Kujdestarët, veçanërisht baballarët, mund të reagojnë dhe të ndërveprojnë ndryshe me djemtë dhe me vajzat.

Shkalla e vdekshmërisë tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 3.2.1 Ndarjet gjinore


Kosovë



Vdekshmëria e foshnjeve: probabiliteti i vdekjes midis lindjes dhe ditëlindjes së parë
Vdekshmëria nën moshën 5 vjeçare: probabiliteti midis lindjes dhe ditëlindjes së pestë

Shkalla e vdekshmërisë tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 3.2.1 Ndarjet gjinore

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Vdekshmëria e foshnjeve: probabiliteti i vdekjes midis lindjes dhe ditëlindjes së parë
Vdekshmëria nën moshën 5 vjeçare: probabiliteti midis lindjes dhe ditëlindjes së pestë

() Shifrat që bazohen në 250-499 raste të papeshuar të personave në vitet e ekspozimit ndaj rrezikut të vdekjes

Kequshqyerja: Nëneshë (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç

Kosovë




Nëneshja i referohet një fëmije i cili është shumë i shkurtër për moshën e tij/saj, dhe/ose shumë i dobët për gjatësinë e tij/saj

() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Kequshqyerja: Nëneshë (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Nëneshja i referohet një fëmije i cili është shumë i shkurtër për moshën e tij/saj, dhe/ose shumë i dobët për gjatësinë e tij/saj

Çdo vajzë dhe djalë mbijeton dhe zhvillohet: Dekada e parë e jetës

Kequshqyerja: Ngecje në rritje (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 2.2.1


Kosovë



Ngecja në rritje i referohet një fëmije shumë të shkurtër për moshën e tij/saj () Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Kequshqyerja: Ngecje në rritje (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 2.2.1


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Ngecja në rritje i referohet një fëmije shumë të shkurtër për moshën e tij/saj

Kequshqyerja: Mbipeshë (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 2.2.2


Kosovë



Mbipesha i referohet një fëmije shumë të rëndë për gjatësinë e tij/saj () Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Kequshqyerja: Mbipeshë (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 2.2.2


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Mbipesha i referohet një fëmije shumë të rëndë për gjatësinë e tij/saj

Kequshqyerja: Peshë e vogël për gjatësinë (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 2.2.2


Kosovë



Peshë e vogël për gjatësinë i referohet një fëmije shumë të dobët për gjatësinë e tij/saj () Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Kequshqyerja: Peshë e vogël për gjatësinë (E moderuar dhe e rëndë) tek fëmijët nën 5 vjeç, SDG 2.2.2

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Peshë e vogël për gjatësinë i referohet një fëmije shumë të dobët për gjatësinë e tij/saj

Çdo vajzë dhe djalë mbijeton dhe zhvillohet: Dekada e parë e jetës

Stimulimi i hershëm dhe kujdesi nga të rriturit

Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeçare me të cilët anëtarët e rritur të familjes u angazhuan në aktivitete që promovojnë mësimin dhe gatishmërinë për shkollë gjatë tre ditëve të fundit, sipas personit që ndërvepron me fëmijën dhe gjininë e fëmijës.

Shënim: Aktivitetet përfshijnë: leximi i librave për fëmijën; tregimi i tregimeve për fëmijën; këndimi i këngëve për fëmijën; dalja me fëmijën jashtë shtëpisë; luajtja me fëmijën; dhe emërtimi, numërimi ose vizatimi i gjërave me fëmijën

Indeksi i zhvillimit të hershem të fëmijës, SDG 4.2.1


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç të cilët janë në rrugën e duhur zhvillimore në të paktë 3 nga 4 fushat e mëposhtme: shkrim/lexim-numërim, fizike, socio-emocional, dhe fushat e të mësuarit, sipas gjinisë

Stimulimi i hershëm dhe kujdesi nga të rriturit

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeçare me të cilët anëtarët e rritur të familjes u angazhuan në aktivitete që promovojnë mësimin dhe gatishmërinë për shkollë gjatë tre ditëve të fundit, sipas personit që ndërvepron me fëmijën dhe gjininë e fëmijës.

Shënim: Aktivitetet përfshijnë: leximi i librave për fëmijën; tregimi i tregimeve për fëmijën; këndimi i këngëve për fëmijën; dalja me fëmijën jashtë shtëpisë; luajtja me fëmijën; dhe emërtimi, numërimi ose vizatimi i gjërave me fëmijën

Indeksi i zhvillimit të hershem të fëmijës, SDG 4.2.1

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç të cilët janë në rrugën e duhur zhvillimore në të paktë 3 nga 4 fushat e mëposhtme: shkrim/lexim-numërim, fizike, socio-emocional, dhe fushat e të mësuarit, sipas gjinisë

Çdo vajzë dhe djalë mbrohet nga dhuna dhe shfrytëzimi: Dekada e parë e jetës

Regjistrimi i fëmijëve në lindje është hapi i parë ku sigurohet që ata njihen para ligjit, të drejtat e tyre mbrohen dhe gjithashtu çdo shkelje e këtyre të drejtave nuk mbetet pa u vënë re. Edhe pse kjo gjë është shumë të rëndësishme si për vajzat ashtu edhe për djemtë, pasojat që vijnë nga niveli i ulët i regjistrimit në lindje, për vajzat, janë të theksueshme, duke i bërë ato më të cenueshme ndaj formave të caktuara të shfrytëzimit nga të cilat rrezikohen më shumë, përfshirë martesat e fëmijëve dhe trafikimin ndërkombëtar. Megjithatë, niveli mesatar i regjistrimit në lindje është i ngjashëm si për vajza ashtu edhe për djem, për fëmijët nënë e të cilëve nuk janë të arsimuara, shanca të regjistrohen në lindje janë më të vogla. Ndërsa vajzat dhe djemtë përballen me rreziqe të ngjashme të përjetimit të disiplinës së dhunshme - që përfshin ndëshkimin fizik dhe agresionin psikologjik - nga kujdestarët në shtëpi, pabarazia gjinore dhe dhuna në familje janë ndër faktorët që lidhen me një rrezik të lartë të dhunës ndaj vajzave dhe djemve.

Regjistrimi i lindjes, SDG 16.9.1 sipas gjinisë


Kosovë



Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç lindjet e të cilëve janë regjistruar, të zbërthyer sipas gjinisë, nivelit të arsimit të nënës dhe kuintilëve të pasurisë.

Disiplinimi i dhunshëm, SDG 16.2.1 sipas gjinisë

Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 1-14 vjeçare që kanë përjetuar disiplinë të dhunshme në muajin e kaluar, sipas gjinisë

Shënim: Grupmosha 1-14 përfshin dekadat e para dhe të dyta të jetës.

Regjistrimi i lindjes SDG 16.9.1 sipas gjinisë


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç lindjet e të cilëve janë regjistruar, të zbërthyer sipas gjinisë, nivelit të arsimit të nënës dhe kuintilëve të pasurisë.

Disiplina e dhunshme, SDG 16.2.1 sipas gjinisë

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 1-14 vjeçare që kanë përjetuar disiplinë të dhunshme në muajin e kaluar, sipas gjinisë

Shënim: Grupmosha 1-14 përfshin dekadat e para dhe të dyta të jetës.

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflektonte pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovën dhe mostrën për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në MICS për Kosovën, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e pasurisë të llogaritura, pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikon.


Çdo vajzë dhe djalë mëson: Dekada e parë e jetës

Investimi në shërbime cilësore të arsimit në fëmijëri të hershme para fillimit të shkollës përmirëson rezultatet e të nxëniet për fëmijët. Gjithashtu ndikon në rritjen e efikasitetit të sistemit shkollor duke ulur shkallën e përsëritjes dhe braktisjes dhe duke përmirësuar arritshmërinë, veçanërisht në mesin e vajzave dhe grupeve të marginalizuara. Arsimi fillor është themelor për mësim gjatë gjithë jetës. Progres i konsiderueshëm është arritur në arsimin universal dhe mbylljen e hendekut gjinor, por pabarazitë gjinore në disavantazh të vajzave ende ekzistojnë në disa vende. Për më tepër, vajzat ende përbëjnë shumicën e popullsisë në botë që janë të pashkolluara.

Shënim: Për shkak se fëmijët e moshës së shkollës fillore variojnë nga 6-10 vjeç, këta tregues përfshijnë disa fëmijë në dekadën e tyre të dytë të jetës.

Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar, SDG 4.2.2


Kosovë



Shpërndarja e përqindjes së fëmijëve të moshës një vit më të ri se moshja zyrtare e fillimit të shkollës fillore në fillim të vitit shkollor që ndjekin edukimin në fëmijërinë e hershme ose arsimim fillor (shkalla neto e vijueshmërisë, i adaptuar), sipas gjinisë

Vijueshmëria e shkollës fillore


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që ndjekin shkollën fillore ose të mesme (shkalla neto e vijueshmërisë, i adaptuar), sipas kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit (urban/rural)

Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar, SDG 4.2.2


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Shpërndarja e përqindjes së fëmijëve të moshës një vit më të ri se moshja zyrtare e fillimit të shkollës fillore në fillim të vitit shkollor që ndjekin edukimin në fëmijërinë e hershme ose arsimim fillor (shkalla neto e vijueshmërisë, i adaptuar), sipas gjinisë

Vijueshmëria e shkollës fillore


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që ndjekin shkollën fillore ose të mesme (shkalla neto e vijueshmërisë, i adaptuar), sipas kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit (urban/rural)


Çdo vajzë dhe djalë mëson: Dekada e parë e jetës

Fëmijët e moshës së shkollës fillore që nuk vijnë shkollën Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që nuk vijnë shkollën fillore ose të mesme të ulët, sipas kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Përfundimi i shkollës fillore, SDG 4.1.2 Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeç mbi moshën e parashikuar për klasën e fundit të shkollës fillore që kanë përfunduar arsimin fillor, sipas gjinisë

Fëmijët e moshës së shkollës fillore që nuk vijnë shkollën Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që nuk vijnë shkollën fillore ose të mesme të ulët, sipas kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Përfundimi i shkollës fillore, SDG 4.1.2 Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeçare mbi moshën e parashikuar për klasën e fundit të shkollës fillore që kanë përfunduar arsimin fillor, sipas gjinisë

Mesazhet kryesore


- Ndonëse nuk ka asnjë ndryshim në shkallën e vdekshmërisë ndërmjet vajzave dhe djemve në popullatën e përgjithshme, djemtë që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë kanë dy herë më shumë gjasa të vdesin para ditëlindjes së tyre të pestë sesa vajzat.
- Djemtë dhe vajzat nën moshën 5 vjeçare janë të prekur në mënyrë të ngjashme nga ngecja në rritje, nënpusha, peshë e vogël për gjatësinë dhe mbipeshë.
- Në mesin e fëmijëve nën 5 vjeç që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptiane, rreziku për të pasur ngecje në rritje është më i madh për fëmijët nënat e të cilëve nuk kanë arsim, këta fëmijë kanë pothuajse 10 herë më shumë gjasa të kenë ngecje në rritje krahasuar me fëmijët, nënat e të cilëve kanë nivele më të larta arsimor.
- Ndërsa prevalenca e përgjithshme e stimulimit të hershëm dhe kujdesit të përgjegjshëm është relativisht e ulët, anëtarët e rritur të ekonomisë familjare kanë po aq gjasa të angazhohen me djem të moshës 2-4 vjeçare në aktivitete që promovojnë të mësuarit dhe përgatitjen për shkollë sikurse me vajzat. Sidoqoftë, si për vajzat ashtu edhe për djemtë, angazhimi i babait në aktivitete me fëmijë është shumë më i ulët krahasuar me nënat.
- Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar është e ngjashme për djemtë dhe vajzat, megjithatë, fëmijët që jetojnë në popullatën e përgjithshme kanë dy herë më shumë gjasa të ndjekin një program arsimor të fëmijërisë së hershme sesa fëmijët nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- Djemtë e moshës së shkollës fillore që jetojnë në ekonomitë familjare më të varfëra në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë më shumë gjasa të mos ndjekin shkollën sesa vajzat (27 përqind e djemve nuk ndjekin shkollën krahasuar me 18 përqind e vajzave nga ekonomitë familjare më të varfëra).
- Pavarësisht pabarazive në nivelet e vijshmërisë së shkollës fillore ndërmjet djemve dhe vajzave që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përqindje e ngjashme e djemve dhe vajzave e përfundojnë arsimin fillor.

Çdo vajzë dhe djalë adoleshent mbijeton dhe zhvillohet: Dekada e dytë e jetës

Derisa adoleshencën bart rreziqe të reja shëndetësore si për vajzat ashtu edhe për djemtë, vajzat shpesh përballen me cenime specifike gjinore, të cilat kanë pasojë gjatë gjithë jetës. Komplikimet në lidhje me shtatzëninë dhe lindjen e fëmijëve janë ndër shkaqet kryesore të vdekjes në të gjithë botën për vajzat adoleshente të moshës 15 deri në 19 vjeçare. Parandalimi i shtatzënisë në adoleshencë jo vetëm që përmirëson shëndetin e vajzave adoleshente, por gjithashtu u siguron atyre mundësi për të vazhduar arsimimin e tyre, duke i përgatitur ato për punë dhe jetë, duke rritur vetëbesimin e tyre dhe duke u dhënë atyre më shumë mundësi për marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre. Megjithatë, shumë shpesh, vajzat adoleshente nuk kanë qasje në shërbimet e duhura të shëndetit seksual dhe riprodhues, duke përfshirë edhe metodat moderne të kontrëpsionit. Për më tepër, pavarësisht se kanë një rrezik më të lartë të prekjës nga HIV për shkak të dobësive më të mëdha fiziologjike dhe pabarazive gjinore, vajzat adoleshente shpesh kanë më pak njohuri se djemtë adoleshentë për mënyrën e transmetimit të HIV. Sidoqoftë, normat gjinore ndikojnë negativisht edhe tek djemtë adoleshentë. Për shembull, normat rreth burrërisë që inkurajojnë marrjen e rrezikut mund të rrisin përdorimin e alkoolit dhe duhanit nga djemtë adoleshentë, duke rritur gjasat e tyre për të zhvilluar sëmundje jorgjithëse më vonë në jetë.

Përdorimi i kontrëpsive dhe kërkesa e plotësuar

Kosovë




Përdorimi i kontrëpsive dhe kërkesa për planifikim familjar të plotësohet me metoda moderne në mesin e grave të moshës 20-24 vjeçare që janë të martuara ose në bashkjetesë, sipas vendbanimit

() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Shënim: Treguesit për gratë e moshës 20-24 vjeçare janë llogaritur për këtë pasqyrë dhe nuk janë paraqitur në Tabelat TM.3.1 dhe TM.3.3 në Raportin e Gjetjeve të Anketës

Përdorimi i kontrëpsive dhe kërkesa e plotësuar

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përdorimi i kontrëpsive dhe kërkesa për planifikim familjar të plotësohet me metoda moderne në mesin e grave të moshës 20-24 vjeçare që janë të martuara ose në bashkjetesë, sipas vendbanimit

() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Shënim: Treguesit për gratë e moshës 20-24 vjeçare janë llogaritur për këtë pasqyrë dhe nuk janë paraqitur në Tabelat TM.3.1 dhe TM.3.3 në Raportin e Gjetjeve të Anketës

Lindja e hershme e fëmijëve - deri në moshën 18 vjeçare


Kosovë



Përqindja e grave të moshës 20-24 vjeçare që kanë lindur deri në moshën 18 vjeçare, sipas nivelit të arsimit

Lindja e hershme e fëmijëve - deri në moshën 18 vjeçare

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e grave të moshës 20-24 vjeçare që kanë lindur deri në moshën 18 vjeçare, sipas nivelit të arsimit

() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Njohuri gjithëpërfshirëse për HIV


Kosovë



Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15-19 vjeçare që dinë për dy mënyrat e parandalimit të HIV (të kesh vetëm një partner besnik të pa infektuar dhe përdorimi i rregullt i kondomit), të cilët janë të vetëdijshëm se një person që në pamje duket i shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv, dhe refuzimi i dy keqkuptimeve më të zakonshme, dhe keqkuptimeve tjera lokale.

Njohuri gjithëpërfshirëse për HIV

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15-19 vjeçare që dinë për dy mënyrat e parandalimit të HIV (të kesh vetëm një partner besnik të pa infektuar dhe përdorimi i rregullt i kondomit), të cilët janë të vetëdijshëm se një person që në pamje duket i shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv, dhe refuzimi i dy keqkuptimeve më të zakonshme, dhe keqkuptimeve tjera lokale.

Çdo vajzë dhe djalë adoleshente mbrohen nga dhuna dhe shfrytëzimi: Dekada e dytë e jetës

Adoleshenca paraqet cenueshmëri unike ndaj dhunës dhe shfrytëzimit tek vajzat. Në shumë vende, martesja para moshës 18 vjeçare është realitet për vajzat për shkak të bashkëveprimit të disa faktorëve që e vendosin një vajzë në rrezik, duke përfshirë varfërinë, normat shoqërore, zakonore ose ligjet fetare që lejojnë këtë praktikë, korniza joadekuata legislative dhe gjendja e sistemit të regjistrimit civil të një vendi. Martesa e fëmijëve shpesh komprometon zhvillimin e vajzave duke rezultuar në shtatzëni të hershme dhe izolim shoqëror, duke ndërprerë shkollimin e saj dhe duke kufizuar mundësitë e saj për karrierë dhe progres profesional. Gjithashtu shpeshherë ndodhë që moshja e vajzës dhe partnerit ka dallim të madh, gjë që e zhvlerëson më tej dhe e vënë në rrezik më të madh të dhunës nga partneri, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe mungesës së veprimeve. Qëndrimet rreth rrahjes së gruas shërbejnë si tregues për pranueshmërinë shoqërore të dhunës nga partneri intim. Pranimi i rrahjes së gruas ndërmjet vajzave dhe djemve adoleshentë sugjeron që mund të jetë e vështirë për vajzat e martuara që përjetojnë dhunë të kërkojnë ndihmë dhe për vajzat e pamartuara të identifikojnë dhe negociojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të barabarta. Gjymtimi gjenital i femrave është çështje e të drejtave të njeriut që prek vajzat dhe gratë. Adoleshenca, në veçanti, është një periudhë e ndjeshme për vajzat që mund të përjetojnë pasoja të mëdha, pasi ato bëhen aktive seksualisht dhe fillojnë lindjen e fëmijëve. Diskriminimi i bazuar në gjini mund të jetë një nga format më të përhapura të diskriminimit me të cilin përballen vajzat adoleshente, dhe ai ka efekte afatgjata dhe të gjera në trajektoret e tyre personale, si dhe në të gjitha aspektet e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Edhe pse në shumicën e vendeve, vajzat dhe djemtë kanë të njëjtën mundësi të përfshihen në punën e fëmijëve, gjinia është përcaktuese e llojeve të aktiviteteve që bëjnë djemtë dhe vajzat, ku vajzat janë më shumë të përfshira në punët e shtëpisë.

Martesa e fëmijëve, SDG 5.3.1

Kosovë



Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeçare që ishin martuar për herë të parë ose në bashkjetesë para moshës 15 vjeçare dhe para moshës 18 vjeçare*, sipas vendbanimit dhe kuintilëve të pasurisë

Dallimi në moshë ndërmjet bashkëshortëve


Kosovë



Shpërndarja e përqindjes së femrave të moshës 20-24 vjeçare aktualisht të martuara ose në bashkjetesë, ndarë sipas moshës së partnerit të tyre, sipas nivelit të arsimit dhe kuintilëve të pasurisë
() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Martesa e fëmijëve, SDG 5.3.1


Komunitetet Rom, Ashkall dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeçare që ishin martuar për herë të parë ose në bashkjetesë sipas moshës së partnerit të tyre, sipas nivelit të arsimit dhe kuintilëve të pasurisë
() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Dallimi në moshë ndërmjet bashkëshortëve

Komunitetet Rom, Ashkall dhe Egjiptian në Kosovë




Shpërndarja e përqindjes së femrave të moshës 20-24 vjeçare aktualisht të martuara ose në bashkjetesë sipas moshës së partnerit të tyre, sipas nivelit të arsimit dhe kuintilëve të pasurisë
() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Çdo vajzë dhe djalë adoleshent mbrohen nga dhuna dhe shfrytëzimi: Dekada e dytë e jetës

Ndjenen të sigurtë, SDG 16.1.4 Të ndara sipas moshës dhe gjinisë


Kosovë



Përqindja e adoleshentëve të moshës 15-19 vjeç që ndjenen të sigurt të ecin të vetëm në lagjen e tyre pas muzgut, sipas gjinisë

Qëndrimet ndaj dhunës në familje


Kosovë



Përqindja e adoleshentëve të moshës 15-19 vjeç që arsyetojnë dhunën fizike ndaj gruas për ndonjë nga arsyet në vijim: del nga shtëpia pa i treguar; i neglizhon fëmijët; grindet me të; nuk pranon të ketë marrëdhënie seksuale me të; e djeg ushqimin; sipas gjinisë dhe grupmoshës

Ndjenen të sigurtë, SDG 16.1.4 Të ndara sipas moshës dhe gjinisë

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e adoleshentëve të moshës 15-19 vjeç që ndjenen të sigurt të ecin të vetëm në lagjen e tyre pas muzgut, sipas gjinisë

Qëndrimet ndaj dhunës në familje

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e adoleshentëve të moshës 15-19 vjeç që arsyetojnë dhunën fizike ndaj gruas për ndonjë nga arsyet në vijim: del nga shtëpia pa i treguar; i neglizhon fëmijët; grindet me të; nuk pranon të ketë marrëdhënie seksuale me të; e djeg ushqimin; sipas gjinisë dhe grupmoshës

Çdo vajzë dhe djalë adoleshent mbrohet nga dhuna dhe shfrytëzimi: Dekada e dytë e jetës

Puna e fëmijëve, SDG 8.7.1

Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri në 17 vjeç që punojnë, sipas gjinisë dhe llojit të veprimtarisë

* Shënim: Treguesi përfshinë fëmijët në dekadën e parë dhe të dytë të jetës

Puna e fëmijëve, SDG 8.7.1

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri në 17 vjeç që punojnë, sipas gjinisë dhe llojit të veprimtarisë


* Shënim: Treguesi përfshinë fëmijët në dekadën e parë dhe të dytë të jetës

Çdo vajzë dhe djalë adoleshent ka mundësi të barabartë në jetë: Dekada e dytë e jetës

Për t'u fuqizuar, vajzat dhe djemtë adoleshentë duhet të angazhohen si pjesëmarrës civil në vendimet që ndikojnë jetën dhe komunitetet e tyre. Ndjenja e sigurisë dhe të mos pasurit frikë nga krimi ka ndikim të njerëzimit se si lëvizin në ato komunitete, si i qasen shërbimeve dhe mundësive ekonomike dhe marrin pjesë në jetën publike. Vajzat dhe djemtë adoleshentë kanë gjasa të kenë perceptime të ndryshme për sigurinë personale për shkak të cënueshmërive të ndryshme të bazuara në gjini ndaj dhunës seksuale dhe krimeve tjera. Kënaqshmëria me jetën e matë nivelin e perceptuar nga një individ për mirëqenien apo se si ndihet një individ për jetën e tij si tërësi. Matja e kënaqshmërisë së vajzave dhe djemve adoleshentë me jetën e tyre mund të jap informacione të rëndësishme për shëndetin e tyre mendor gjatë fazës së jetës kur konsolidohen normat gjinore dhe vajzat dhe djemtë përjetojnë faktorë të ndryshëm të rrezikut për çrregullimet e shëndetit mendor.

Diskriminimi & Ngacmimi


Kosovë



Përqindja e vajzave dhe djemve adoleshentë të moshës 15-19 vjeç që janë ndjerë të diskriminuar apo ngacmuar, sipas gjinisë

Diskriminimi & Ngacmimi

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e vajzave dhe djemve adoleshentë të moshës 15-19 vjeç që janë ndjerë të diskriminuar apo ngacmuar, sipas gjinisë

Çdo vajzë dhe djalë adolescent mëson: Dekada e dytë e jetës

Globalisht, pjesëmarrja në arsimin e mesëm është duke u rritur, nuk ka progres në arsimin fillor. Pabarazitë gjinore që nuk i favorizojnë vajzat janë më të mëdha dhe ndodhin në më shumë vende në nivel të mesëm se sa në nivelin fillor. Prandaj, avancimi i arsimit të mesëm të vajzave është njëra nga strategjitë zhvillimore më transformuese në të cilat mund të investojë vendi. Përfundimi i arsimit të mesëm sjell përfitime të konsiderueshme pozitive për vajzat dhe shoqëritë – nga rritja e fitimeve gjatë gjithë jetës dhe normave të rritjes kombëtare deri te zvogëlimi i martesave të fëmijët, ngecja në rritje dhe vdekshmërisë së fëmijëve dhe nënave.

Vijimi i shkollës së mesme të ulët Shkalla neto e vijueshmërisë


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës për shkollë të mesme të ulët që vijnë në shkollë të mesme të ulët apo të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar) sipas gjinisë, kuartilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Vijimi i shkollës së mesme të lartë Shkalla neto e vijueshmërisë


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës për shkollë të mesme të lartë që vijnë në shkollë të mesme të lartë apo të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar) sipas gjinisë, kuartilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Vijimi i shkollës së mesme të ulët Shkalla neto e vijueshmërisë

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës për shkollë të mesme të ulët që vijnë në shkollë të mesme të ulët apo të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar) sipas gjinisë, kuartilëve të pasurisë dhe vendbanimit

() Shifrat që bazohen në 25–49 raste të pashuara

Vijimi i shkollës së mesme të lartë Shkalla neto e vijueshmërisë

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës për shkollë të mesme të lartë që vijnë në shkollë të mesme të lartë apo të lartë (shkalla neto e vijueshmërisë, e adaptuar) sipas gjinisë, kuartilëve të pasurisë dhe vendbanimit

() Shifrat që bazohen në 25–49 raste të pashuara

Çdo vajzë dhe djalë adoleshent mëson: Dekada e dytë e jetës

Përfundimi i shkollës së mesme të ulët, SDG 4.1.2


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeç më të mëdhenj se mosha e synuar për klasën e fundit të shkollës së mesme të ulët, të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët, sipas gjinisë

Përfundimi i shkollës së mesme të lartë, SDG 4.1.2


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeç më të mëdhenj se mosha e synuar për klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë, të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët, sipas gjinisë

Përfundimi i shkollës së mesme të ulët, SDG 4.1.2


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeç më të mëdhenj se mosha e synuar për klasën e fundit të shkollës së mesme të ulët, të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët, sipas gjinisë

Përfundimi i shkollës së mesme të lartë, SDG 4.1.2

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeç më të mëdhenj se mosha e synuar për klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë, të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët, sipas gjinisë

Fëmijët e moshës së shkollës së mesme që nuk janë në shkollë




Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që nuk vijojnë shkollën fillore të mesme të ulët apo të mesme të lartë, sipas kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit



Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që nuk vijojnë shkollën fillore të mesme të ulët apo të mesme të lartë, sipas kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit
() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Menaxhimi i higjienës menstruale

Kosovë




Aftësia e vajzave adoleshente për të menaxhuar në mënyrë të sigurt ciklin e tyre menstrual në privatësi dhe me dinjitet është themelore për shëndetin, mirëqenien psiko-sociale dhe lëvizshmërinë e tyre. Vajzat me resurse të ulëta dhe kontekste emergjente pa qasje në objekte dhe furnizime për menaxhimin e duhur të higjienës menstruale përjetojnë stigmë dhe përjashtim social, duke braktisur gjithashtu mundësi të rëndësishme arsimore, sociale dhe ekonomike.

Menaxhimi i higjienës menstruale: Nga vajzat adoleshente të moshës 15–19 që kanë raportuar se kanë pasur menstruacione në 12 muajt e fundit, përqindja që përdorin material të përshtatshme për higjienë gjatë menstruacioneve me vend privat për pastrim dhe ndërrim përderisa gjenden në shtëpi

Menaxhimi i higjienës menstruale

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përrjashtimi nga aktivitetet gjatë menstruacioneve: Nga vajzat e moshës 15-19 që kanë raportuar se kanë pasur menstruacione në 12 muajt e fundit, përqindja e grave që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete sociale, shkollë apo punë për shkak të menstruacionit të tyre të fundit në 12 muajt e fundit

Mesazhet kryesore

- 1 në 20 gra të moshës 20–24 vjeçare në Kosovë që janë të martuara apo në bashkëjetesë përdorin metoda moderne kontraceptive – 1 në 14 e bëjnë planifikimin familjar sipas metodave moderne.
- 1 në 6 gra të moshës 20–24 vjeç që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë pasur lindje të gjalla deri në moshën 18 vjeçare. Gratë e kësaj moshe që nuk janë të arsimuara kanë 5 herë më shumë gjasa që të kenë lindje të gjallë deri në moshën 18 vjeçare se sa ato me arsim të mesme të lartë apo më të lartë.
- 1 në 3 gra të moshës 20–24 vjeçare që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë martuar para moshës 18 vjeçare, me incidencën e martesës së fëmijëve që rritet në 1 në 2 të gratë

që jetojnë në ekonomitë familjare më të varfëra.

- Edhe pse 95 përqind e djemve të moshës 15-19 vjeçare në popullsinë e përgjithshme ndihen të sigurt të ecin të vetëm në lagjen e tyre pas muzgut, 65 përqind e vajzave. 48 përqind e vajzave dhe 85 përqind e djemve të moshës 15-19 vjeç që jetojnë në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane ndihen të sigurt duke ecur vetëm në lagjen e tyre pasi të errësohet.
- Nga vajzat e moshës 15-19 vjeç që jetojnë në popullsinë e përgjithshme, si dhe ato që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 1 në 10 raportojnë se janë ndier të diskriminuara në bazë të gjinisë së tyre.
- Djemtë që jetojnë në ekonomitë familjare më të varfëra në Kosovë kanë më pak gjasa t'i vijojnë mësimet në shkollë e mesme të lartë se sa vajzat (64 përqind në krahasim me 76 përqind, përkatësisht)

- 2 në 3 djem dhe 1 në 2 vajza në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian e përfundojnë arsimin e mesëm. Kjo bie në 1 në 3 djem dhe 2 në 5 vajza në arsimin e mesëm të lartë.


- Edhe pse shumica e vajzave adoleshente të moshës 15-19 vjeç që kanë raportuar që kanë pasur menstruacione në 12 muajt e fundit përdorin material të përshtatshme për higjienë menstruale me vend privat për pastrim dhe ndërrim përderisa gjenden në shtëpi, 14 përqind në popullsinë e përgjithshme dhe 20 përqind të atyre që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian nuk kanë marrë pjesë në aktivitete sociale, shkollë apo punë për shkak të menstruacionit të tyre të fundit në 12 muajt e fundit.

Barazia gjinore në moshën e rritur

Për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar, të gjithë fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe mbështetje nga gratë dhe burrat. Kujdesi dhe mbështetja mund të përmirësohen në mënyrë thelbësore duke nxitur barazinë gjinore, një qëllim i rëndësishëm, dhe duke zvogëluar barrierat e ndërlidhura me gjininë. Barrierat e ndërlidhura me gjininë përfshijnë mungesën joproporcionale të informacioneve, njohurive dhe teknologjisë, resurseve dhe sigurisë dhe lëvizshmërisë të gratë dhe vajzat, ndarjen e punës në baza gjinore dhe normat gjinore. Për shembull, mungesa e lëvizshmërisë së një nëne për shkak të normave ndaluese apo mungesës së transportit, mund të pengojë regjistrimin e lindjes, ushqimin dhe rezultatet tjera të fëmijës. Përvetësimi i normave gjinore për pritjet dhe sjelljet mashkullore dhe femërore mund të ndikojnë te qëndrimet e grave dhe burrave ndaj dhunës nga partneri me të cilin ka marrëdhënie intime dhe ndëshkimin fizik të fëmijëve, si dhe vetë-perceptimet e mirëqenies, përfshirë, kënaqshmërinë me jetë dhe pritjet për të ardhmen.


Qasja në njohuri & burime

Shkrim-leximi
Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 vjeç që dijnë shkrim-lexim, sipas gjinisë


Mbulimi me sigurim shëndetësor
Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 vjeç me sigurim shëndetësor, sipas gjinisë, kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Shkrim-leximi


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 vjeç që dijnë shkrim-lexim, sipas gjinisë

Mbulimi me sigurim shëndetësor

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 vjeç me sigurim shëndetësor, sipas gjinisë, kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Koha e kaluar në punët e shtëpisë: Mbushja e ujit

Kush shkon të mbush ujë?


Kosovë



Përqindja e shpërndarjes së pjesëtarëve të ekonomisë familjare pa ujë të pijshëm në shtëpi sipas personave që zakonisht mbushin ujë të pijshëm që përdoret në ekonomi familjare

Koha e kaluar për mbushjen e ujit


Kosovë



Përqindja e shpërndarjes së kohës mesatare të kaluar për mbushjen e ujit gjatë ditë sipas gjinisë së personit që e ka përgjegjësinë kryesore për mbushjen e ujit në ekonomitë familjare pa ujë të pijshëm në shtëpi
Nuk ka pasur raste të femrave dhe meshkujve që kalojnë mbi 3 orë në ditë për mbushjen e ujit të pijshëm dhe as raste të grave që e kalojnë mbi 1 orë deri në 3 orë

Kush shkon të mbush ujë?


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e shpërndarjes së pjesëtarëve të ekonomisë familjare pa ujë të pijshëm në shtëpi sipas personave që zakonisht mbushin ujë të pijshëm që përdoret në ekonomi familjare

Koha e kaluar për mbushjen e ujit

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e shpërndarjes së kohës mesatare të kaluar për mbushjen e ujit gjatë ditë sipas gjinisë së personit që e ka përgjegjësinë kryesore për mbushjen e ujit në ekonomitë familjare pa ujë të pijshëm në shtëpi
Nuk ka raste të femrave dhe meshkujve që kalojnë më shumë se 1 deri në 3 orë apo mbi 3 orë në mbushjen e ujit çdo ditë

Barazia gjinore në moshë madhore

Siguria

Ndjenen të sigurt kur ecin vetëm, SDG 16.1.4 sipas gjinisë


Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15-49 vjeçare që ndjenen të sigurt kur ecin vetëm në lagje pas muzgu, sipas gjinisë dhe vendbanimit

Ndjenen të sigurt kur gjenden vetëm në shtëpi


Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15-49 vjeçare që ndjenen të sigurt kur janë vetëm në shtëpi pas muzgu, sipas gjinisë dhe vendbanimit

Diskriminimi dhe ngacmimi


Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15-49 vjeçare që janë ndjerë ndonjëherë personalisht të diskriminuar në bazë të gjinisë së tyre, sipas gjinisë dhe vendbanimit

Ndjenen të sigurt kur ecin vetëm, SDG 16.1.4 sipas gjinisë


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15-49 vjeçare që ndjenen të sigurt kur ecin vetëm në lagje pas muzgu, sipas gjinisë dhe vendbanimit

Ndjenen të sigurt kur gjenden vetëm në shtëpi


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15-49 vjeçare që ndjenen të sigurt kur janë vetëm në shtëpi pas muzgu, sipas gjinisë dhe vendbanimit

Diskriminimi dhe ngacmimi

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e të rriturve të moshës 15-49 vjeçare që janë ndjerë ndonjëherë personalisht të diskriminuar në bazë të gjinisë së tyre, sipas gjinisë dhe vendbanimit

Barazia gjinore në moshë madhore

Qëndrimet dhe pritjet femërore dhe mashkullore

Qëndrimet ndaj dhunës në familje


Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 që e arsyetojnë dhunën fizike ndaj bashkëshortes për njërin nga arsyet në vijim: largohet nga shtëpia pa i treguar; i neglizhon fëmijët; refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me të; e djeg ushqimin, sipas gjinisë, kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Qëndrimet ndaj ndëshkimit fizik (nënat /kujdestare)

Kosovë




Përqindja e nënave/kujdestareve që besojnë se ndëshkimi fizik është i nevojshëm për rritjen apo edukimin e fëmijës në mënyrë të duhur, sipas gjinisë së kujdestarit

Shënim: Përqindja e burrave bazohet në më pak se 25 raste të papeshuara dhe nuk është paraqitur

Qëndrimet ndaj dhunës në familje


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 që e arsyetojnë dhunën fizike ndaj bashkëshortes për njërin nga arsyet në vijim: largohet nga shtëpia pa i treguar; i neglizhon fëmijët; refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me të; e djeg ushqimin, sipas gjinisë, kuintilëve të pasurisë dhe vendbanimit

Qëndrimet ndaj ndëshkimit fizik (nënat /kujdestaret)

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e nënave/kujdestareve që besojnë se ndëshkimi fizik është i nevojshëm për rritjen apo edukimin e fëmijës në mënyrë të duhur, sipas gjinisë së kujdestarit

Shënim: Përqindja e burrave bazohet në më pak se 25 raste të papeshuara dhe nuk është paraqitur

Mesazhet kryesore

- Edhe pse pothuajse të gjitha gratë dhe burrat e moshës 15–49 vjeçare në Kosovë dijnë shkrim-lexim, vetëm 2 në 3 gra dhe 4 në 5 burra që jetojnë në Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dijnë shkrim-lexim.
- Përqindja e të rriturve të moshës 15–49 vjeçare me sigurim shëndetësor në Kosovë është e ulët në përgjithësi. Megjithatë, burrat që jetojnë në ekonomitë familjare më të pasura kanë më shumë gjasa të kenë sigurim

shëndetësor si në popullsinë e përgjithshme ashtu edhe ata që jetojnë ekonomitë familjare më të pasura në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Nga pjesëtarët e ekonomisë familjare pa ujë të pijshëm në shtëpi, burrat e moshës 15 vjeçare apo më shumë kanë më shumë gjasa që të mbushin ujë për përdorim në ekonomitë familjare se sa gratë (76 përqind në krahasim me 7 përqind).

Midis grave të moshës 15–49 vjeç që jetojnë

në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 70 përqind që jetojnë në zona urbane dhe 61 përqind që jetojnë në zona rurale ndihen të sigurt që qëndrojnë vetëm në shtëpi pasi të errësohet.

- Gratë e moshës 15–49 vjeçare që jetojnë në ekonomitë familjare më të varfëra në Kosovë kanë dyfish më shumë gjasa sa burrat që të arsyetojnë dhunën fizike ndaj bashkëshortes për ndonjërin nga arsyet që janë përmendur në anketë.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë kryer në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), Fondi i Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara (UNICEF), Fondi i Popullsisë i Kombeve të

Bashkuara (UNFPA) Qeveria e Luksemburgut dhe UN Women.

Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS e Kosovës 2019-2020 dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019-2020 në Kosovë lidhur me Barazinë Gjinore. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat CS.3, TC.8.1, TC.10.1, TC.11.1, PR.1.1, PR.2.1, LN.1.2, LN.2.3, LN.2.4, LN.2.6, LN.2.7, TM.3.1, TM.3.3, TM.2.2W, TM.11.1W/M, SR.6.1W/M, PR.8.1W/M,

PR.2.2, EQ.3.1W/M, PR.7.1W/M, EQ.2.1W/M, WS.4.1, WS.4.2, WS 1.3 and WS.1.4 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat e shkurtra informative të mëtejshme statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.